



PËR TË RINJTË

Mësim nga mëshira e Perëndisë

JONAI—PJESA 2

Udhëzime: Shqyrtoje këtë material në ambient të qetë. Ndërsa lexon shkrimet, imagjino sikur merr pjesë edhe ti në ngjarje. Përfytyroje skenën. Dëgjoji zërat. Përpiku të provosh ndjenjat e personazheve. Jetoje tregimin.

1 ANALIZO NGJARJEN.—LEXO JONAIN 3:1–4:11.

Si mendon se u ndie Jonai kur hyri në qytetin e Ninevisë? _____

Çfarë ndjenje të krijon zëri i Jonait tek shpallte gjykimin e Jehovahit? _____

Çfarë duhet ta ketë mundur Jonain kur u ul jashtë qytetit? (Shih Jonain 4:5-8.)

2 KËRKO MË THELLË.

Pse mund të ketë dashur Jonai që Jehovahi ta shkatërronte Ninevinë siç kishte thënë? _____

Duke përdorur materialet që ke për kërkime, gjej informacione për (1) pamjen dhe veçoritë e bimës së kungullujësit dhe (2) çfarë kuptimi kishte që mbreti i Ninevisë u mbulua me copë thesi dhe u ul në hi. _____

Edhe pse në fillim ngurroi të profetizonte në Ni-nevi, pse Jonai mund të quhet profet i besueshëm dhe i guximshëm? (Mateu 21:28-31) _____

**3 NXIRR DOBI NGA AJO QË MËSOVE.
SHKRUAJ SE ÇFARË MËSOVE PËR . . .**

Faktin që njerëzit janë në gjendje ta braktisin udhën e ligë.

Mëshirën e Jehovahit.

Mëshirën që duhet të tregojmë ne.

**4 ÇFARË TË VLEJTI MË SHUMË
NGA KY TREGIM DHE PSE?**

Për kërkime të tjera, shih *Kullën e Rojës* të 1 prillit 2009, faqet 14-18.

